



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:085531

Datë: 02.09.2022

Numri i dokumentit: 03386778

P.nr.155/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i përgjithshëm, gjyqtarja e vetme gjykuese Diana Sina me bashkëpunëtoren profesionale Kaltrina Halilaj, në lëndën penale kundër të akuzuarit A. A. nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë, me numër PP/II.nr.577/22 të datës 26.04.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar **me datën 11.08.2022**, në prezencën e Prokurorit të shtetit Enis Gashi si dhe të akuzuarit, po të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 23.08.2022 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **A. A.**, data e lindjes . . . në fshatin . . ., Komuna e Gjakovës, ku edhe tani banon në rrugën “. . .”, nga i ati Sh. dhe e ëma G., e vajzërisë A., i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, punëtor, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës me numër personal . . .

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse: Me datë 09.02.2022, rreth orës 00:10/h, në rrugën “. . .” në Gjakovë, pa autorizim ka poseduar narkotik, substanca psikotrope ose analoge të shpallura të rrezikshme e në kundërshtim me nenin 9 dhe 14 të Ligjit për Barnat Narkotike, Substanca Psikotrope dhe Prekusore Nr.02/L-128, dhe atë narkotikun e llojit Marihuanë, në atë mënyrë që zyrtarët policor deri sa kanë qenë në detyrë zyrtare në rrugën e lartcekur aty ndalin veturën e markës “. . .”, me targa të regjistrimit . . ., ngjyrë vishnje të cilin e drejtonte i akuzuari ku gjatë kontrollit trupor nga ana e zyrtarëve policor tek i akuzuari, i është gjetur një sasi të substancës narkotike e dyshuar si Marihuan të cilën e kishte fshehur në pjesën gjenitale, e cila substancë narkotike sekuestrohet nga ana e zyrtarëve policor, ku pas ekzaminimit laboratorik të narkotikut në bazë të raportit të ekspertimit Nr.ref: AKF/2022-0672/2022-645, të datës 04.03.2022, rezulton të jenë substancë narkotike Kanabis (Marihuanë) që përmban Tetrahidrokanabinol (THC), me pesha neto të përgjithshme 0.32-0.0001 gram.

- me çka ka kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4,17.par.1, 38, 39, 40, 43, 69, 70 dhe nenit 269 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-ës, si dhe nenit 365 të KPP-së, i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Dënim me gjobë në shumë prej **150.00.-€ (njëqind e pesëdhjetë euro)**, të cilin dënim është i detyruar që ta paguaj në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, Gjykata në bazë të nenit 46 par.3 të KPP-së, dënimi me gjobë do ta zëvendësoi me dënim burgu në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) ditësh, duke llogaritur çdo ditë të qëndrimit në burgim nga 20.00-€ (njëzet euro), të gjobës.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **20.00 euro**, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej **30.00 euro**, e të gjitha këto në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

Ndaj të akuzuarit konfiskohet substanca narkotike e llojit Kanabis me peshë 0.32-0.0001 gram, komfor nenit 269 par.3 të KPRK-së.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë me numër PP/II.nr.577/22 të datës 26.04.2022 kundër të akuzuarit A. A. nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, duke propozuar gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari A. A. në shqyrtimin fillestar, pas sqarimeve të mjaftueshme nga ana e Gjykatë për pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë, lidhur me fajësinë ka deklaruar se: e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohem ashtu siç është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, për të cilën vepër jam penduar pa masë, duke premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë të njëjtën, shton se jam në gjendje të dobët materiale, jam punëtor fizik, punoj herë pas here kur ka punë, jam konsumues i substancave narkotike, por përdori shumë rrallë, do të mundohem që në të ardhmen mos ta konsumoj, për herë të parë paraqitem për një vepër të kryer penale por premtoj se do të jetë edhe hera e fundit, andaj i propozoj gjykatës që të merr parasysh rrethanat e lartpërmendura me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit.

Duke u deklaruar lidhur me mendimin rreth pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit Prokurori i Shtetit Enis Gashi ka deklaruar se: nuk e kundërshtojmë pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të akuzuarit pasi që pranimi është bërë në mënyrë vullnetare dhe pas sqarimeve të mjaftueshme nga ana e gjykatës, po ashtu ky pranim gjen mbështetje të plotë edhe në provat që mbështesin aktakuzën, prandaj gjykatës i propozoj që pranimin e fajësisë si shprehje të lirë të vullnetit ta pranojë dhe të akuzuarit të i shqiptojë një dënim të merituar konform ligjit, duke vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe njëherit të obligohet në pagesën e shpenzimeve procedurale.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtarja e vetme gjykuese pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari A. A. për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-së, pranimi është bërë në kuptim të dispozitave të nenit 248 të KPP-së, i akuzuari i kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi bëhet vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjyqtarja e vetme gjykuese ka vërtetuar këto gjendje faktike se:

I akuzuari A. A. nga fshati . . . , Komuna e Gjakovës, ka kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruara si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 269 paragrafi 1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge e kryen: “Kushdo që pa autorizim posedon narkotikë, substanca psikotrope apo analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet”, ndërsa në par.2 të po këtij neni parashihet ” kryesi që kryen veprën nga paragrafi 1. i këtij neni për herë të parë dhe i cili posedon më pak se tre (3) gram të substancave narkotike apo substancave psikotropike ose analoge dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit”

5. Vendimi i gjyqtarës së vetme gjykuese

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht e ka pranuar fajësinë, Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtarja e vetme gjykues konstatoi se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike

Duke u bazuar në këto që janë cekur më lartë, gjyqtarja e vetme gjykuese të akuzuarin A. A. e ka shpallur fajtorë për veprën penale për të cilën ngarkohet ngase në veprimet e të akuzuarit të përshkruara në dispozitivin e aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale, posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-së, bazuar në këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e matjes së dënimit, Gjykata i ka pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të parapara nga neni 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikonin në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Si rrethanë lehtësuese, Gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të

akuzuarit: gjendjen e tij të dobët ekonomike, sjelljet tejet korrekte në gjykim, sjelljet e tij para kryerjes së veprës penale ka qenë korrekt qytetar i rëndomtë dhe asnjëherë nuk ka rënë ndesh me ligjin, më parë nuk ka qenë i dënuar. Në këtë drejtim ka ndikuar veçanërisht personaliteti i tij që për Gjykatën është kuptuar si njeri i sjellshëm, korrekt dhe i vetëdijshëm për pasojën e shkaktuar, është pënduar thellë për veprën penale të kryer. Ndërsa si rrethana posaçërisht lehtësuese gjykata vlerësoi pranimin e fajësisë, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë këtë vepër penale apo vepra penale të ngjashme, duke mos gjetur rrethana rënduese, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në parandalimin të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij do të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor, është marrë konform nenit 450 paragrafi 1 dhe 2 lidhur me nenin 453 paragrafi 1 të KPP-së, si dhe për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit duke u bazuar në nenin 39 paragrafi 3, nënparagrafi 3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm -
P.nr.155/22 me datën 11.08.2022

Bashkëpunëtorja profesionale,
Kaltrina Halilaj

Gjyqtarja e vetme gjyqësore,
Diana Sina

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.